




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Kuvendi Komunal-Kamenicë  
Më: 01.04.2026

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja d) neni 17 paragrafi 1 shkronja g) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr. 28/2008), dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-027 për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera, neni 12 paragrafi 1 pika 1.6 të Rregullores (QRK) Nr. 17/2015 për metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, Vendimi Sh. 02.Nr. 20609, i datës 26.06.2024, për themelimin e Komisionit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Sh. 02.Nr. 20290, të datës 29.07.2025, si dhe neni 38 të Statutit të Komunës së Kamenicës, Sh. 01.Nr. 20203, datë 21.06.2023, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur me datë: 27.03.2026 miratoi këtë:

### VENDIM

#### Për miratimin e raportit të Komisionit Komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera

1. Me këtë vendim miratohet raporti i Komisionit Komunal me nr. **Sh.01 Nr. 6083 i datës 09.03.2026** për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, sipas të cilit vlera e dëmit të shkaktuar është 1.760.00 Euro.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i Komisionit Komunal Sh. 01.Nr. 6083, i datës 09.03.2026, për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjencë në Komunën e Kamenicës.
4. Vendimi hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose në ueb-faqen zyrtare të Komunës.

*Vendimi i'u dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Shërbimit të Kuvendit, Zyrës së Informimit, Zyrës së Përkthimeve, DSHPAIE-së, MAPL-së, QSHQ-Arkivit.*

Kryesuesë e Kuvendit Komunal

Arbnore BEQIRAJ FERA



